



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:167495

Datë: 17.07.2024

Numri i dokumentit: 05949521

KPPP.nr.926/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli në rr. "UÇK" Nr. 4, në Prishtinë, kundër debitorit "Auto District" SH.P.K., me NUI: 811300433, me seli në rr. "Nëna Terezë" p.n., në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Rafet Ferizi, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.693/23 të datës 21.08.2023 të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 17.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit "Auto District" SH.P.K., ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.693/23 i datës 21.08.2023, i Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.693/23 të datës 21.08.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. 201912590 të datës 19.12.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që pas pranimin të këtij urdhri t'i paguaj kreditorit shumë prej 1,200.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, në të kundërtën përmbushja e detyrimeve, të realizohet me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit, si dhe me sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen sendeve deri në përmbushjen e borxhit të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke deklaruar se fatura mbi bazën e të cilave kreditori ka parashtruar propozimin për përmbartim nuk përbën bazë ligjore për fillimin e procedurës së përmbartimit, për faktin se në rastin konkret kreditori nuk është kompetent për të ngarkuar debitorin në këtë procedurë, ngase lokali afarist është saktësisht në komunën e Graçanicës, rrjedhimisht kjo komunë është subjekti i autorizuar sipas Ligjit për financat e pushtetit lokal që të lëshoj për kreditoren faturën për ngarkesën e taksës vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste. Më tutje ka shtuar se nuk mund debitori të paguaj në të njëjtën kohë taksën në fjalë edhe për një komunë tjetër, kur lokali me të cilin operon me biznesin e tij ndodhet jashtë Komunës së Prishtinës. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri përmbartimi, si dhe të përfundohet në tërësi kjo çështje përmbartimore.

Kreditore në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar prapësimin e debitorit, ku ndër të tjerash ka deklaruar se dokumenti përmbartues i nxjerrë në procedurë administrative/kundërvajtëse është bërë i përmbartueshëm konform nenit 30 paragraf. 4 të Ligjit Nr. 05/L-087 Për Kundërvajtje. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit, të vërtetohet urdhri për përmbartim, si dhe të obligohet debitori që të përmbush obligimin sipas urdhrin përmbartimor së bashku me shpenzimet e procedurës përmbartimore deri në përfund të kësaj çështje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 paragraf. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. 201912590 e datës 19.12.2022, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 paragraf.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 paragraf. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe*

*se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se është pranuar nga debitori në çfarëdo forme. Andaj duke qenë së debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt këtë faturë, e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm.

Gjykata vlerësoi pretendimin e kreditorit se në rastin konkret fatura është e përmbarueshme konform nenit 30 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është tërësisht i pa bazuar, pasi që kjo dispozitë rregullon vetëm afatet për pagesën e gjobave të lëshuara sipas vendimeve për kundërvajtje.

Prandaj duke marr për bazë të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti mbi të cilën mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm pasi që nuk ka tipare të përmbarueshmërisë.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.926/24, datë 17.07.2024.

Gjyqtari  
Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.